

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-Departamenti për çështje ekonomike, me gjyqtaren Franciska Zhitia-Ymeri duke vendosur lidhur me çështjen juridike të paditësit N.SH “ I. A” me seli në Prishtinë,të cilin e përfaqëson av.A. A. nga P.,ndaj të paditurit Qeveria e Kosovës-Ministria e Punëve të Mbrendshëm në Prishtinë të cilën e përfaqësoi përfaqësuesja e qeverisë Naime Abazi nga Prishtina , për kompensimin e dëmit material,në seancën e shqyrtimit kryesor të datës; 12.11.2014,në prani të të autorizuarit të paditësit dhe të autorizuarit të të paditurëve,ndërsa pas marrjes së fjalëve përfundimatrë të palëve ndërgjyqëse, me datën;25.11.2014 merr këtë:

A K T G J Y K I M

APROVOHET Pjesërishtë si e bazuar padia dhe kërkesëpadia e paditësit N.SH “ I. A” me seli në P. dhe,

I.DETYROHET e paditura Qeveria e Kosovës-Ministria e Punëve të Mbrendshëm në Prishtinë ,që paditësit N.SH “ I. A” me seli në P. t’ia paguaj shumën në dhe atë:

- 1.1 538.114,50 euro (pesqind e tridhjet e tetë mijë e njëqind e katërmëdhjet euro e pesëdhjet cent),në emër të fitimit të humbur për periudhen kohore prej 10 muaj (01.07.2012-26.04.2013),
- 1.2 Shumën prej 53.979.89 euro(pesëdhjet e tre mijë e nënqind e shtatëdhjet e nënë euro e tetëdhjet e nëntë cent) për shkak të mospërbushjes së detyrimit ndaj paditësit për banesat e mara me qira me arsyetimin se ato nuk kanë përmbushë kushtet për përdorim,
- 1.3 Shumën prej 10.717,90euro (dhjetë mijë e shtatëqind e shtatëmbëdhjet euro e nëntëdhjet centë) në emër të zbritjes së shumës së fakturave të paditësit për banesat e dhënë me qira në objektin në sllatinë Komuna e Fushë Kosovës e si rrjedhoj e korigjimit së sipërfaqës së shfrytëzuar dhe
- 1.4 Shumën prej 41.433,75 euro(katëmbëdhjet e një mijë e katërqind e tridhjet e tri euro e shtatëdhjetë e pesë cent) në emër të fitimit të humbur si pasoj e mos realizimit të të ardhurave që do ti realizonte paditësi po të mos nderprehej shfrytëzimi i banesave rezervë e paraparë në nenin 1 të kontratës e të cilat janë 10 banesa të tilla të përllogaritura prej datës 01.02.2012 e deri në skadimin e kontratës e datës 26.04.2013 të gjitha këto me kamatë ligjore prej 3.5%,duke filluar nga data 01.08.2012 e deri në pagesën definitive, në afat prej 7 (shtatë) ditësh pas plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënimin e përmbarimit me detyrim.

II.REFUZOHET kërkespadia e paditësit në shumë prej 200,000.00euro(dyqind mijë euro) në emër të cenimit të autoritetit të paditësit në mjetet e informimit publik,me inicimin e procedurës hetimore ndaj R. K..

III.DETYROHET e paditura t’ia paguaj paditësit shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 2,179.00në afat prej 7 (shtatë) ditësh pas plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënimin e përmbarimit me detyrim.

A r s y e t i m

Paditësi N.SH "I." me seli në P. pranë kësaj gjykate ka paraqit padi me të cilën ka kërkuar që e paditura Qeveria e Kosovës-Ministria e Punëve të Mbrendshëm në Prishtinë t'ia kompenzoj fitimin e humbur dhe dëmin e shkaktuar për shkak të ndërprerjes të njëanshme të kontratës së lidhur në mesë të paditësit dhe të paditurit me nr.indetifikimit 214-11-011-111 e datës 21.04.2011.

Paditësi gjatë shqyrtimit kryesor ka potencuar se nga e paditura ka kërkuar që mbrenda afatit të paraparë nga neni 22 të kontratës së lart përmendur të miren vesh respektivisht e paditura të spjegoj arsyet e shkëputjes së kontratës,me qenëse e paditura e ka njoftuar paditësin për vendimin nr.463 e datës 19.06.2012 të marrë nga bordi për monetërimin e strategjisë për rientegrimin e personave të riadhesuar.Paditësi gjithashtu ka pontecuar se edhe në vendimin e bordit të lartë përmendur nr.463/12 e datës 19.06.2012 nuk janë theksuar apo shpalos arsyet e shkëputjes së njëanshme të kontratës .Po ashtu paditësi ka theksuar se që nga data e lidhjes së kontratës e deri në qershorë të vitit 2012 e paditura nuk ka pasur vretje e as sygjerime lidhur me përmësimin dhe zbatimin e kontratës andaj paditësi i konsideron veprimet e paditurit si shkeputje e një anshme të kontratës.Paditësi po ashtu ka pontecuar se ka pas dëme të konsiderushëm material për shkak të shpenzimeve për përgaditjen kapaciteteve njerzore dhe material lidhur me sigurimin e akumudimit të 211 banesave në territorin e Kosovës . Dëmi si fitim të humbur e edhe dëm për shkak së humbjes së imazhit.

E paditura në përgjigje në padi e thekson se e konteston padinë në tërësi duke mos kontestuar faktin se në mesë të paditurës dhe paditësit është lidhë kontrata me nr idetifikimi 214-11-011-111 e datës 26.04.2011 për marrjen e banesave me qira në të cilat do të vendoseshin familjet e rikthyera.E paditura ka theksuar se e ka njoftuar paditësin me 25.05.2012 se nuk e ka për detyrim ligjor të kujdeset për rrjedhjen e procesit të riadhësimit të personave të kthyer. E paditura ka shtuar se komisioni për verifikimin e banesave ka përpiluar raportin për gjendjen e banesave me rastin e verifikimit në teren nr.447 e datës 15.06.2012 me c' rast ka konstatuar se 124 banesa ishin në gjendje shumë të mirë,16 banesa të dobët,ndërsa për 7 banesa ka propozuar të ndërpritet kontrata e për 14 banesa nuk kanë gjetur persona të akomoduuar.Po ashtu e paditura ka cek se me datën 19.06.2012 me shkresë elektronike e ka njoftuar paditësin me vendimin për shkëputjen e kontratës për shkak të mos përmbushjes së detyrimeve.

Paditësi me datë 24.09.2012 gjykatës ja paraqet parashtrësën lidhur me përgjigjiet e të paditurës në padi ku thekson:

-e paditura asnjëherë nuk ja ka dorëzuar paditësit raportin e komisionit për vlerësimin e gjendjes së banesave dhe atë për 211 banesa të raportuara.Thekson se vlerësimi i gjendjes së tyre është bërë pa njoftim ,pa prezencën ,dhe pa dijenin e paditësit.Konsideron se prezenca e paditësit ka qenë obligative me qenëse ka qenë furnizues i banesave. Paditësi theksonse të gjitha banesat në mënyrë të rregullt janë dorëzuar me fletëpranim dhe ato janë pranur nga e paditura e njëherit edhe nga akumenduari pa asnjë vretje.

-Thekson se vendimi mbi shkëputjem e kontratës nuk përmban arsye mbi shkëputjen e kontratës nuk përmban arsye të shkëputjes së saj.Ka theksuar se e paditura nuk ka paguar fatura në shumë prej 59.445.06euro dhe nuk ka dhënë e paditura asnjë arsyetim.

Gjykata duke i vlerësuar pretendimet e paditësit, dhe të paditurit ,e po ashtu edhe provat të bashkangjitura padis dhe përgjigje në padi,ka administruar këto prova dhe at; kontrata publike korniz e furnizimit me nr.214110111111 e datës 26.04.2011,njoftim I paditurës dt.19.06.2012,takimi I dt.19.07.2012,vendimi me nr.463/2012 e dt. 14.06.2012,me 3 shtojca,imellat e paditurës e dt.25.05.2012,raporti I verifikimit të banesave të lëshuar me qira për personat e riadhesuar me nr 447 e dt.15.06.2012, imellat(njoftimi) I paditurës e dt.19.06.2012 lidhur me shkëputjen e kontratës,raporti I komisionit për verifikimin e kushtetve të banimit në object-banesat ku janë të akomoduar me qira personat e riadhesuar e datës 23.07.2012,fotodokumentacionet e të paditurës të bashkangjitura parashtresës së datës 30.11.2012,dokumentet financiare për pagesat e kompani së paditësit me nr 810 e dt.08.11.2012,ekzekutimi I pagesës për objektin Sllatinë , raportit I komisionit me nr 1703 e dt.22.05.2012, njoftimi I personave zyrtar të kimunave në territorin e Kosovës lidhur me vendosjen dhe kushtet e të riadhesuarit në banesa si dhe fotografit e paditësit,vretja e paditurës, aktvendimi me nr PP.809-3/2012 e dt.04.07.2014 e lëshuar nga Departamenti për Krime të Rënda, si dhe me propozimin e paditësit ka marrë aktvendim mbi caktimin e ekspertit financiar,duke kërkuar nga ai:

-të vërtetoi fitimin e humbur duke llogaritur nga data e shkëputjes së kontratës e deri me datën e skadimit të saj,

-të caktoj lartësin e fakturave të pa paguara prej datës 01.01.2012 e deri me datë 30.06.2012,

-të vërtetoi lartësin e pagave të të punësuarve për periudhen 01.06.2012 e deri më datë 24.04.2013,

-të vërtetoi edhe fakte të tjera eventuale të cilat rrjedhin nga shkresat e lëndës dhe të cilat mund të jenë me ndikim të rëndësishëm për gjykatësn.

Pas seancave të shqyrtimit kryesor, pas administrimit të provave dhe ndëgjimit të fjalëve përfundimtare të palëve në procedurë dhe dëgjimit dhe dhënjeve së përgjigjeve të ekspertit financiar në të gjitha pyetjet e gjykatës dhe palëve në procedurë e edhe pas shpjegimit të konstatimeve të tija.

Gjykata ka gjetë si në vijim:

Nuk është kontestuese se në mesë paditësit dhe të paditures me datën 26.04.2011 është lidhë kontrata publike kornizën e furnizimeve e cila për objekt ka”marrja e banesave me qira për familjet e riardhësuar me nr.të idetifikimit 214-11-011-111.

Në kontratën e largë përmendur,më konkretisht në nenin 1 përveq tjerash parashihet,marrja e banesave me qira për familjet e kthyer,kontraktuesi duhet të ketë në disponim 10 banesa të gatshme për banim në 5 rregjione të Republikës së Kosovës në cdo moment ndërsa sasia tjetër e banesave duhen të sigurohet mbrenda 7 ditëve pas njoftimit –kërkesës nga autoriteti kontraktues-paditurës.

Furnizuesit nuk i lejohet të bëj ndryshime të cmimeve të njësis dhe sasisë varsisht nga nevojat e autoritetit kontraktues.Në nenin 2 të kontratës së lart përmendur janë paraprë cmimet për njësi të cilat janë specifikuar sipas rregjioneve . Në këtë nenë është paraparë që

tatimim mbi qiran bie në garkesë të qiradhënsit ndërsa shpenzimet e rrymës,ujit dhe mbeturinave në ngarkesë të Ministris së Punëve të Mbredshme.

Neni 3 i kontratës parasheh punimet e përgjithshme të pagesave sipas të cilave autoritete kontraktuese do ti shlyej detyrimet e veta në llogarin bankare të furnizuesit mbrenda 30 ditëve nga data e rregjistrimit të kërkesës për pagesë,e cila kërkesë duhet të jetë e kompletuar me dokumentacion.Parashihet se në rast mos pagesës në afatë pa fajin e furnizuesit, furnizuesi mbrenda 2 muaj ka të drejtë të kërkoj kamatën ligjore.Në nenin 19 të kësaj kontrate është parapar procedurat e ndërprerjes së kësaj kontrate.Më konkretisht autoritete kontraktues mundet që pasi të jap furnizuesit 7 ditë paralajmërim ta ndërpresë kontratën në ndonjërin prej rasteve të cilat janë 15 sish . Më hollësisht të shikohet neni 19 i kontratës në fjalë.

Neni 22 të kontratës në fjalë është paraparë zgjidhja miqësore e marrveshjeve pra është paraparë që palët kontraktues të bëjnë përpjekje për të zgjidhur të gjitha mosmarrveshjet që mund të ndodhin.Eshtë paraparë që palët do ta lajmërojnë njera tjetrën me shkrim për qendrimit e tyre dhe do të propozojnë do një zgjedhje eventuale.Me këtë dispozitë është paraparë edhe afati për përgjigje në kërkesën e njëres palë nga tjetra e cili afat është 15 ditë e më së largu do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës.

Nuk është kontestuese se e paditura me datën 19.06.2012 në formë elektronike e ka njoftuar paditësin për shkëputjen e kontratës dhe atë me këtë përmbatje” Ju njoftojmë se Bordi për monitorimin e strategjisë për ri integrimin e personave të ri ardhësuar, ka nxjerr Vendimin nr.463 i datës 19.06.2012, me të cilin , shkëputet kontrata “Marrja e banesave me qira për familjet e këthyera “ me nr ; 214 11 011 111.Shkëputja e kontratës bëhet qe nga data 01.07.2012, për shkak të mos permbushjes së obligimeve që dalin nga kjo kontratë.

Nuk është kontestuese se me datën 19.07.2012 është realizuar një takim pune në mesë të përfaqësuesve të palëve në procedurë.Në këtë shkresë rezulton se është kërkuar arsyetimi I shkëputjes së kontratës dhe në njoftimin se vendimin mund të meret në zyrën për komunikim me publikun,ndërkaq që nga shkresa nuk shihet të jetë bërë fjalë për vretjet konkrete të autoritetit kontraktues,përkitazi me mospërmbushjen apo jo të detyrimeve të furnizuesit, në rastin konkret paditësit.

Nga vendimi për shkëputjen e kontratës Gjykata vërteton faktin se ky vendim është pranuar me vones të konsiderushme nga paditësi dhe në këtë vendim nuk saktësohet as një arsye apo shkakë për ndërprerjen –zgjidhjen e kësaj kontrate sikurse janë arsyet e nenit 19 të kontratës në fjalë. Po ashtu gjykata nga përmbatja e këtë vendim për shkëputjen e kontratës gjen se nuk është respektuar neni 20 i kontratës i cili korespodon me nenin 22të të njejtës kontratë. Nga raporti i komisionit të verifikimit të gjendjes së banesave nr.447 datës 15.06.2012 gjykata e vërteton faktin se 124 banesa janë gjeti në gjendje shumë të mirë të cilat i plotëson të gjitha kriteret e kontratës,50 banesa janë gjetë në gjendje të mirë-mesatare me të cilët janë akomoduarit dhe ato janë deklaruar se nuk dëshirojnë të ndrojnë, 16 banesa janë gjetur në gjendje të dobët por të akomoduarit insistojnë të mbeten në to që do të thotë se ato shfrytëzohen.

Ky komision ka rekomanduar shkëputjen e kontratës vetëm për 7 banesa.Për 14 banesa të akomoduarit nuk janë gjetur të akomoduarit dhe është propozuar që këto të verifikohen edhe

njëherë.Pra vetëm 7 banesa sipas këtij komisioni nuk i kanë plotësuar kushtet dhe është propozuar shkëputja e kontratës.E paditura nuk ka arritur ta provoj faktin se lidhur me këto raporte të komisionit për verifikimin e banesave ta ketë njoftuar paditësin, të ketë kërkuar ndryshimin e gjendjes apo ti është dhënë ndonjë vretje përkitazi për këto banesa.

Po ashtu Gjykata konstaton se edhe një komision i dytë në përbërje prej M. H.,I. R. dhe Sh.H. me datë 23.07.2012 është paraqitë një raport tjetër me nr.505 ku rezulton se raporti është përpiluar pa dalë në vend shiqimi i cili është bazuar në raportin e komisionit paraprak dhe mbi bazën e të dhënave të raportit të parë dhe fotove ta kenë bërë analizën përkatëse me c' rast kanë konstatuar se 171 banesa janë në kushte të mira ,12 banesa nuk janë të mira për të cilat është rekomanduar që të meren masa nga departamenti i prokurimit dhe për 24 banesa kanë konstatuar se nuk mund të ipet vlerësimi për shkak të mungesës së fotografive dhe se banuesit nuk janë gjetur në banesa me rastin e visitës nga komisioni i parë.Andaj gjykata konstaton se raporti i komisionit të dytë nuk korespondon me raportin e parë .Është për tu cekur se raporti i dytë është përpiluar pas shkëputjes së kontratës për 23 ditë dhe ky raport është jo lëndore për faktin se veq paraprakisht është shkëputër kontrata. Po ashtu Gjykata gjen se fakti jo kontestues se zyrtarët e Ministrisë së Punës së Mbrendshme gjithëherë e kanë bërë pranimin e banesave në rastin e akomodimit të personave të kthyer e që nënkupton se ato banesa kanë qenë në gjendje të rregullt në të kundërtën nuk do të pranoheshin për akomodim.

Po ashtu gjykata nga provat e administruara e vërteton faktin se në periudhën prej nënshkrimit të kontratës e deri në ndërprerjen e saj që nënkupton periudhën kohore prej 14 muajve,rezulton se paditësi për nevojat e paditurit ka siguruar 211 banesa dhe atë në rregjionin e Prishtinës 73 banesa,në Pejë 75 banesa,në Prizren 21 banesa,në Gjilanë 10 banesa, dhe në Mitrovicë 32 banesa.

Më hollësisht eksperti financiar në mënyrë tabelare në tabelën nr.1 ka paraqit periudhën e përllogaritjes së shfrytëzimit të këtyre banesave sipas rregjioneve. Eksperti financiar në pjesën e shtojcave të bashkëqitura ekspertizës ka pasqyruq të dhënat mbi nr.e fletëpranimit, emrin e kryefamiljarit,sipërfaqen e banesës,cmimin për metër katror, shumën e qirasë mujore,numrin e muajve të akomodimit, si dhe shumën totale të qirasë.

Gjykata po ashtu vërteton faktin lidhur me faturat për banesat në shfrytëzim në të gjitha regjionet si dhe diferenca e pagesave të bëra kundrejtë faturimit pa objektim në Sllatinë për vendosje të përkohshme 1-7 ditë.

Nga ekspertiza financiare konstatohet se zbritja e shumës së faturave është bërë në mënyrë arbitrare dhe pa përfillje të procedurave ligjore të parapara me standartet financiare dhe se kjo diferencë e paguar më pak kundrej shumës së faturave të parashtruara paraprakisht është në shumë prej 53,979,68 euro e që në fakt është zbritje pa mbështetje ligjore.

Lartësin e fitimit të humbur gjykata e ka vërtetuar nga mendimi dhe konstatimi I ekspertit financiar që kap shumën prej 538,114,50 euro që nënkupton periudhën 10 mujore.Po ashtu shumën lidhur me fitimin e humbur si pasoj e mos realizimit të të ardhurave që do ti realizonte paditësi po të mos të ndërpriej shfrytëzimin e banesave rrezervë e paraparë me nenin 1 të kontratës (nevoja për 10 banesa rezervë), në shmë prej 41,433.75euro, gjykata e ka vërtetuar nga mendimi dhe konstatimi I ekspertit . Shumën prej 10,717.90euro në emër të

zbritjes së shumës së faturave të paditësit për banesa e dhëna me qira në objektin në Sllatinë si rrjedhojë e korigjimit të sipërfaqës së shfrytëzuar gjykata e ka vërtetuar nga mendimi dhe konstatimi e ekspertit financiar.

Kjo Gjykatë vlerëson se deri të shkëputja e kontratës respektivisht ndërprerja e kontratës së njëanshme ka ardhë me fajin e të paditurës me që ajo nuk është përmbajtë kushteve të parapara për ndërprerjen e kontratës respektivisht nuk i është përmbatë dispozitave të kontratës së lidhur në mesë paditësit dhe të paditurës.

Më konkretisht e paditura nuk i është përmbajtë nenit 19 të kontratës së lartë përmendur, pikërisht nën paragrafin b të nenin 19 pika 1 ku parashihet se nëse furnizuesi dështon në përmbushjen mbrenda një afati të arsyshëm të paralajmërimit të dhën nga nga autoriteti kontraktues që kërkon nga ai të evitoj ndonjë neglezhenc apo dështim për ta realizuar obligimet e veta sipas kontratës dhe të cilat ndikojnë në mënyrë serioze në realizimin e duhur dhe në kohë të punëve.

Në këtë rast e paditura nuk e ka lajmëruar paraprakisht paditësin për mos përmbushjen e kontratës e as që ka kërkuar nga ai ti evitoj dështimet e veta.

E paditura po ashtu nuk ka përmbush kushtet e parapara në paragrafin 19 pika 4 të nenit 19 të kësaj kontrate , meqenëse e paditura paraprakisht apo pas ndërprerjes së kontratës ka përpiluar raportin pa lajmërim e furnizuesit ose përfaqësuesit e tij. Pra ka bërë vlerësim të njëanshëm të gjendjes për përmbushjen e detyrimeve kontraktuese.

Andaj, gjykata duke vretjtë se e paditura nuk i është përmbajtë dispozitave të kontratës së lidhur dhe në mënyrë të njëanshme e ka ndërprerë kontratën në fjalë dhe kështu paditësit i ka shkaktuar dëm material në mënyrën e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimit. Andaj, gjykata në bazë të nenit 124 lidhur me nenin dhe 132 paragrafi 4 të LMD-së, ku vendosi si u cek më lartë.

Pretehimet e të paditurës se gjoja nuk është rrespektuar neni 22 i kontratës nga paditësi nuk qendron për arsye se neni 22 i kontratës parashih mundësit e zgjidhjes së mosmarrveshjes para ndërprerjes së kontratës e jo pas ndërprerjes së saj. Po ashtu e paditura nuk ka arritë të provoj se ka ndërmarrë do një hapë në drejtim të zgjedhjes së mosmarrveshjes në mënyrë miqësore sikur se parashihet në nenin 22.

Lidhur me vretjet e paditurës për banesat rezerv të Ministris së Punëve të Mbredshme gjykata ka aprovuar mendimin dhe konstatimin ekspertit financiar dhe sqarimin lidhur me vretjet në ekspertizën e datës 15.11.2012 ku në mënyrë të qartë eksperti ka deklaruar se duhet të bëhet kompenzimi pra eksperti e ka konstatuar gjendjen ekzistuese dhe për këtë e ka bërë përlllogaritjen përkatëse.

Sa i përketë pretendimeve të paditurës lidhur me vretjet ndaj konstatimit dhe mendimit të ekspertit në drejtim të asaj se eksperti nuk e ka pas në konsiderat rregulloren nr.10/12 për menagjimin e programit gjykata i vlerësoi sit ë pa bazuar me arsyetim se në rastin konkret kemi të bëjm me mardhënje detyrimore e që është në të paditurin të mendoi dhe të lidh kontratë në përputhje dhe në harmoni me rregullore nr.10/12 të cilën ajo duhet ta zbattoj.

Për pretendimet e të paditurës se në rastin konkret kemi të bëjmë me kornizë publike e cila implemetohet vetëm me vendosjen e porosive nga ana e autoritetve kontraktuese.

Gjykata konstaton se lidhur me këtë është sqaruar në mënyr të mjaftushme eksperti financiar e gjykata konstaton se kontrata në fjalë është vetë në fakt porosi dhe parasheh të drejta dhe detyrimet e dyanshëme dhe mos respektimi i kësaj kontrate shkakton pasoja,repsektivisht ndërprerjen e njëanshme shkakton pasoj për të cilat më hollësisht ka shpjeguar edhe eksperti financiar.

Sa i përket kërkesës për dëmshpërblimin për shkak të prestigjit të humbur gjykata e refuzoi si të pa bazuar dhe të pa mbështetur në dispozitë ligjore.

Meqenëse i padituri, ka rënë në vonesë lidhur me pagesën e borxhit të krijuar, duke u bazuar në nenin 277 të LMD-së, gjykata e detyroj të paditurën që t'ia paguaj paditësit, shumën e gjykuar së bashku me normën e kamatës, në lartësi prej 3,5%,duke filluar nga data e paraqitjes së padisë e deri në pagesën definitive.Lartësia e kamatës në rastin konkret, i referohet shkallës së kamatës,të cilën e paguajnë bankat afariste në Kosovë,për mjetet e deponuara pa destinim për periudhën kohore të deponimit,me më shumë se për një vit.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës kontestimore është marrë në bazë të nenit 452.1 të LPK-së,në rastin konkret shpenzimet e krijuara gjyqësore si detyrim i të paditurit, i referohen shumës së përgjithshme të precizuar si në pikën III të dispozitivit të aktgjykimit, e cila përfshin shpenzimet e kërkuara dhe të argumentuara nga paditësi dhe atë: për hartimin e padisë shumën prej 104,00euro, për taksën e padisë shumën prej 500.00 €, për përfaqësime në 5 seanca (5X135.00 euro) shumën prej 675,00 € dhe taksën për aktgjykim shumën prej 500.00 €,në emër të ekspertizës në shumë prej 400 euro,që do të thotë në shumë të përgjithshme prej 2.179.00 €.Andaj gjykata duke u bazuar në nenin 143 par.1 të LPK-së,ka vendosur si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
-Departamenti për Çështje Ekonomike-
III.C.nr.328/2012, me dt.25.11.2014

Gjyqtarja
Franciska Zhitia-Ymeri

UDHËZIME JURIDIKE: Ndaj këtij aktgjykimi është e lejuar e drejta e ankesës në afatin kohor prej 7 (shtatë) ditëve, duke llogaritur nga dita e pranimit të tij duke iu drejtuar Gjykatës së Apelit në Prishtinë,përmes kësaj gjykate.